



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 07.09.2023

Nr: 182

Ora: 13:15

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 94, DATË 05.09.2023 TË DEPOZITUAR NGA “PARTIA  
DEMOKRATIKE E SHQIPËRISËSË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.09.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Franci Nuri

**PALË E INTERESUAR:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

**OBJEKTI:** Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 745, datë 04.09.2023, çregjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Lulzim Basha dhe regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të përfaqësuar nga z. Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për

zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.

**BAZË LIGJORE:**

Neni 21, pika 1, shkronja “b” dhe neni 123/1, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Në datën 11.08.2023, Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 186, ka caktuar datën 24 Shtator 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në bashkinë Kukës.
2. Në zbatim të procedurave ligjore për regjistrimin në zgjedhje, z. Lulzim Basha, nëpërmjet përfaqësuesit më autorizim, z. Indrit Sefa, ka depozituar pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 6721 prot., datë 01.09.2023, nga ku kërkohet rregjistrimi i “Partisë Demokratike e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkinë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
3. Gjithashtu, z. Sali Berisha, nëpërmjet përfaqësuesit më autorizim, z. Franci Nuri, ka depozituar pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 6711 prot., datë 01.09.2023, për regjistrimin e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 2023.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar të dyja këto kërkesa në një të vetme, duke qënë se kanë të njëjtin objekt.
5. Në kërkesën e tij z. Lulzim Basha, ka paraqitur pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve edhe dokumentacionin përkatës për regjistrimin si subjekt zgjedhor. Pjesë e këtij dokumentacioni janë: Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.8.2023; Deklarat e angazhimit solemn e nënshkruar nga z. Lulzim Basha

(Model KQZ-04-02); Deklarata për hapjen e llogarise bankare të posaçme të partisë politike (Model KQZ 04-03).

6. Në kërkesën e tij z. Sali Berisha, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve edhe dokumentacionin përkatës për regjistrimin si subjekt zgjedhor. Pjesë e këtij dokumentacioni janë: Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02); Vendimi nr. 1346/222 Akti, datë 25.3.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. Në vlerësim të të dyja kërkesave për regjistrim të “Partisë Demokratike” (PDSH) si subjekt zgjedhor, të paraqitura respektivisht nga z. Sali Berisha dhe z. Lulzim Basha, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 745, datë 04.09.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023” vendosi regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronja nistore “PDSH”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.
8. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri, duke kërkuar ndryshimin e vendimit, çregjistrimin e “Partisë Demokratike, përfaqësuar nga z. Lulzim Basha dhe regjistrimin e “Partisë Demokratike”, përfaqësuar nga z. Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.
9. Më datë 06.09.2023, u hodh shorti për relatorin e kërkesës ankimore nr. 94, datë 05.09.2023, nga ku u zgjodh z. Elvis Çefa.
10. Në përfundim të seancës paraprake, me vendim nr. 180, datë 06.09.2023 u vendos pranimi për shqyrtim i kërkesës ankimore.
11. Në seancën e shqyrtimit të kërkesës ankimore që u zhvillua në datën 07.09.2023 morën pjesë përfaqësuesi i ankuesit z. Franci Nuri, përfaqësuesi i palës së interesuar z. Indrit Sefa dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli Merkaç.

12. Përfaqësuesi i ankuesit parashtrori se, ndonëse ky konflikt është zgjidhur një herë në mënyrë përfundimtare për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në favor të subjektit Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Lulzim Basha (me vendimin nr. 5, datë 27.03.2023), zhvillimi i ngjarjeve brenda këtij subjekti politik dhe një numër faktesh juridike që kanë lidhje me kontestimin gjyqësor të zgjedhjes së z. Lulzim Basha në krye të partisë, si dhe mosregjistrimin e tij si kryetar i sapozgjedhur i partisë duhet të ishin marrë në konsideratë nga Komisioneri për të mos pranuar regjistrimin e subjektit sipas kërkesës së z. Lulzim Basha dhe regjistrimin e tij, sipas kërkesës së z. Sali Berisha.
13. Përfaqësuesi i palës së interesuar parashtrori se zhvillimet e brendshme politike nuk ndikojnë tek plotësimi i kërkesave ligjore për regjistrim nga ana e subjektit që ai përfaqëson, regjistrimi në gjykatë i emrit të kryetarit të partisë bëhet vetëm kur ndryshon kryetari dhe jo në çdo rast, sikurse nuk ka afate prekluzive në ligjin për partitë politike, të cilat mund të krijojnë konflikt me kërkesat e Kodit Zgjedhor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Për pasojë kërkesa ankimore duhet të rrëzohet.
14. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
- Dosjen e plotë të vendimit nr. 745, datë 04.09.2023 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”;
  - Kërkesën ankimore nr. 94, datë 05.09.2023;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i janë paraqitur dy kërkesa për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023 për kryetar bashkie në bashkinë Kukës

në emër të të njejtit subjekt politik, Partisë Demokratike të Shqipërisë. Kërkesa me nr. 6721 prot., datë 01.09.2023 është për rregjistrimin e “Partisë Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha, kurse kërkesa me nr. 6711 prot., datë 01.09.2023 është për regjistrimin e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, me kryetar z. Sali Berisha.

2. Komisioneri i ka shqyrtuar kërkesat në një procedurë të vetme administrative, ka pranuar kërkesën me nr. 6721 prot., datë 01.09.2023 për rregjistrimin e “Partisë Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha, por nuk është shprehur për rrëzimin e kërkesës me nr. 6711 prot., datë 01.09.2023 për regjistrimin e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, me kryetar z. Sali Berisha.
3. Kjo mënyrë procedimi e Komisionerit është identike me atë të vendimeve të Komisionerit nr.158, datë 09.03.2023 dhe nr.172, Dt.14.03.2023, me të cilët Komisioneri, pasi bashkoi kërkesat e të njejtave subjekte në një të vetme, i dha rrugë vetëm njerës prej tyre. Atëkohë, Kolegji e konsideroi të rregullt këtë mënyrë procedimi. Me vendimin nr. 5, datë 27.03.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor u shpreh se *“Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, vendimi Nr.172 Dt.14.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (ankimi kundër të cilit ka vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve), **përbën disponim**, si për kërkesën për regjistrim nr.1337 Prot datë 6.3.2023 të Partisë Demokratike, paraqitur me nga z.Indrit Sefa, ashtu edhe për kërkesën nr.1329 Prot, datë 5.3.2023 të Partisë Demokratike, paraqitur nga z.Sali Berisha”*.
4. Mbështetur në këtë arsyetim të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, KAS-i konsideron se vendimi i Komisionerit nr. 745, datë 04.09.2023 përbën disponim për kërkesën me nr. 6711, datë 01.09.2023 për regjistrimin e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, me kryetar z. Sali Berisha. Për pasojë, ankuesi ka legjitimim për të kundërshtuar në rrugë administrative vendimin Nr. 745, datë 04.09.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi për efekt të ligjit konsiderohet palë në procedurën administrative mbi bazën e së cilës është dhënë ky vendim (shkronja “a” e pikës 1 të nenit 33 të Kodit të Procedurave Administrative).

5. Legjitimimi i ankuesit për të kundërshtuar në rrugë administrative vendimin Nr. 745, datë 04.09.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfshin vetëm të drejtën e ankimit për mosregjistrimin e tij sipas kërkesës së paraqitur prej tij, por nuk përfshin të drejtën për të kundërshtuar regjistrimin e palës së interesuar. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është shprehur në vendimin nr. 5, datë 27.03.2023, se *“pala paditëse Partia Demokratike, me kryetar z.Sali Berisha, sakohë që nuk përlligjet në regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimarrjen e KAS në lidhje me regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Ky parashikim ligjor përcakton se vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. Pra, pala paditëse në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor ka të drejtën të ankimojë vendim-marrjen për mosregjistrimin e saj si subjekt zgjedhor siç ka vepruar, kërkim që u rrëzua. Në këto kushte, kërkimin për ç’regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike përfaqësuar nga nënkryetari z. Enklejd Alibeaj, pala paditëse nuk legjitimohet t’a paraqesë para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, sakohë që vetë nuk është subjekt zgjedhor, që më tej t’i cënohen interesat nga vendim-marrja e KAS. Kritere këto të parashikuara në nenin 145 të Kodit Zgjedhor që legjitimojnë palët paditëse para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”*.
6. Shinat që ka vendosur Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin e tij nr. 5, datë 27.03.2023 kërkojnë nga KAS-i që në shqyrtimin e kësaj çështjeje të hetojë nëse ka shkaqe ligjore, rrethana apo fakte që mbështesin regjistrimin në zgjedhje të subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar z. Sali Berisha dhe, nëse po, vetëm atëherë mund të thellohet në hetimin, nëse pretendimet e ankuesit për çregjistrimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Basha janë të mbështetura ligjërisht dhe faktikisht, apo jo.
7. Gjatë shqyrtimit administrativ në KAS, ankuesi nuk parashtroi asnjë rrethanë, fakt apo provë, të cilat të referonin ndryshime në statusin juridik të tij si subjekt politik, që nga koha e vendimeve nr.158, datë 09.03.2023 dhe nr.172, datë. 14.03.2023 të Komisionerit, vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS-it dhe vendimit nr. 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Ankuesi

ndodhet në të njejtat kushte të mosplotësimit të kërkesave të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, sikurse ishte në kohën kur iu refuzua regjistrimi në zgjedhje me vendimet e sipërcituara.

8. Faktet dhe provat e parashtruara nga ankuesi në seancë i referohen ngjarjeve politiko-juridike që nuk kanë lidhje me të, por me palën e interesuar. Këto fakte dhe prova do mund të shqyrtoheshin nga KAS-i vetëm nëse ankuesi do mund të fitonte statusin e subjektit zgjedhor dhe do mund të provonte në procedurë administrative, se regjistrimi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha cënon interesat e ligjshme të tij si subjekt zgjedhor.
9. KAS-i çmon se ankuesi nuk e fiton dot statusin e subjektit zgjedhor, për të njejtat shkaqe, për të cilat i është refuzuar ky status me vendimet nr.158, datë 09.03.2023 dhe nr.172, datë. 14.03.2023 të Komisionerit, vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS-it dhe vendimit nr. 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 94 të ankuesit “Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar z. Sali Berisha.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 745, datë 04.09.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më datë 07.09.2023.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator (Kundër)</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar (Pjesërisht kundër)</b>



## Mendim pakice

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 94 të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga z. Sali Berisha me objekt *“1. Kundërshtimin e vendimit Nr. 745, datë 04.09.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ndryshimin e vendimit duke vendosur Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”*, unë, anëtari në pakicë, duke mos qenë dakord pjesërisht me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jam i mendimit se KAS duhet të pranonte pjesërisht ankimin e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga z. Sali Berisha dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 745, datë 04.09.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke çregjistruar Partinë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga z. Lulzim Basha si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, ndaj paraqes, në vijim, argumentet e mia për këtë qëndrim.
2. Më konkretisht, unë anëtari në pakicë bie dakord me arsyetimin e shumicës së KAS se *“Gjatë shqyrtimit administrativ në KAS, ankuesi<sup>1</sup> nuk parashtoi asnjë rrethanë, fakt apo provë, të cilat të referonin ndryshime në statusin juridik të tij si subjekt politik, që nga koha e vendimeve nr.158, datë 09.03.2023 dhe nr.172, datë. 14.03.2023 të Komisionerit, vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS-it dhe vendimit nr. 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Ankuesi ndodhet në të njëjtat kushte të mosplotësimit të kërkesave të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, sikurse ishte në kohën kur iu refuzua regjistrimi në zgjedhje me vendimet e sipërcituara”* ndërkohë që nuk dakordësoj me arsyetimin se *“Faktet dhe provat e parashtruara nga ankuesi në seancë i referohen ngjarjeve politiko-juridike që nuk kanë lidhje me të, por me palën e interesuar. Këto fakte dhe prova do mund të shqyrtoheshin nga KAS-i vetëm nëse ankuesi do mund të fitonte statusin e subjektit zgjedhor dhe do mund të provonte në procedurë administrative, se regjistrimi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha çënon interesat e ligjshme të tij si subjekt zgjedhor”*.

<sup>1</sup> Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Sali Berisha

3. Shumica e KAS, në arsyetimin për moslegjitimitimin e ankimuesit Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga z. Sali Berisha për ngritjen e pretendimeve për çregjistrimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Lulzim Basha, ka përdorur arsyetimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në vendimin nr. 5, datë 27.03.2023 që po ashtu ka trajtuar çështjen e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, por për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Në këtë vendimmarrje, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, ndër të tjera ka arsyetuar se:

*“Lidhur me disponimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, pika 2, 3 dhe 4 të Vendimit Nr.27 Dt.16.003.2023, që kanë lidhje me regjistrimin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor thekson se pala paditëse Partia Demokratike, me kryetar z.Sali Berisha, sakohë që nuk përlligjet në regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimarrjen e KAS në lidhje me regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Ky parashikim ligjor përcakton se vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. Pra, pala paditëse në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor ka të drejtën të ankimojë vendim-marrjen për mosregjistrimin e saj si subjekt zgjedhor siç ka vepruar, kërkim që u rrëzua. Në këto kushte, kërkimin për ç’regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike përfaqësuar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, pala paditëse nuk legjitimohet t’ua paraqesë para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, sa kohë që vetë nuk është subjekt zgjedhor, që më tej t’i cënohen interesat nga vendim-marrja e KAS. Kriteria këto të parashikuara në nenin 145 të Kodit Zgjedhor që legjitimojnë palët paditëse para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.*

4. Në vijim të këtij arsyetimi të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vlen të sqarohet rrethi i subjekteve që legjitimohen për t’ju drejtuar KAS në raport me rrethin e subjekteve që legjitimohen për t’ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. **Nëse për këtë të fundit, rrethi i subjekteve është**

përcaktuar në mënyrë shteruese nga ligjvënësi në nenin 145 të K.Zgjedhor<sup>2</sup> (dispozitë kjo e referuar nga vetë KZGJ në vendimin e përdorur si argument nga KAS), për KAS rrethi i subjekteve është i pakufizuar për atë kohë se në nenin 124/1 pika 2 të K.Zgjedhor<sup>3</sup> është parashikuar se “Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankimi në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit”. Referuar këtyre dispozitave, KAS nuk duhet ta trajtonte *mot à mot* interpretimin e KZGJ për nenin 145 të K.Zgjedhor me interpretimin që i bën nenit 124/1 të po këtij kodi, pasi qëllimi i ligjvënësit për të shtuar këtë dispozitë në vitin 2020 ka qenë pikërisht zgjerimi i rrethit të subjekteve që mund t’i drejtohen me ankim KQZ kur i cënohen interesat e ligjshme.

5. Po ashtu si në rastin e zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, edhe për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 shtator 2023 rezultoi që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të ketë administruar dy kërkesa të paraqitura në emër të të njëjtit subjekt politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe me të njëjtin objekt, regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, por me të dhëna të ndryshme në dokumentet shoqëruese lidhur me emrin e kryetarit të partisë, të financierit dhe personit/personave përgjegjës për komunikim me KQZ-në. Është fakt i njohur botërisht tashmë, që në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, fraksione të ndryshme të Partisë Demokratike të Shqipërisë janë

<sup>2</sup> “1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi”.

<sup>3</sup> Shtuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020

përfshirë në procese gjyqësore<sup>4</sup> për regjistrimin në gjykatë të ndryshimeve statutores apo për regjistrimin e organeve që përfaqësojnë këtë parti politike me palë të treta. Një pjesë e këtyre vendimmarrjeve janë depozituar edhe në KQZ së bashku me dokumentacionin tjetër për regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Në Gjykatën e Lartë, në datë 24.05.2023, është regjistruar çështja me nr. 90600-00296-00-2023, me objekt *“Depozitim ndryshimesh statutores dhe vendimmarrje te Kuvendit Kombëtar”* ku palë në gjykim janë të dy subjektet që janë edhe palë e këtij shqyrtimi administrativ në KAS.

6. **Për sa më sipër, unë anëtari në pakicë, jam i mendimit që situata në Partinë Demokratike të Shqipërisë kur të njëjtat palë, në mënyrë konsekuente, kanë shfaqur mosmarrëveshje në regjistrimin e kësaj partie politike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe së fundmi në zgjedhjet e pjesshme të datës 24 shtator 2023, mbështetur kjo në prova që tregojnë se të njëjtat palë janë pjesë e një procesi gjyqësor (tashmë në pritje për t’u gjykuar pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë) për pasqyrimin e vendimeve të organeve të kësaj partie politike në Regjistrin e Partive Politike që mbahet nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është e tillë që secila nga palët ka interes të ligjshëm për regjistrimin e saj apo çregjistrimin e palës tjetër si subjekt zgjedhor. Duke qenë se jemi në kushtet e dy fraksioneve të një partie politike që pretendojnë ndër të tjera edhe drejtimin e saj (për rrjedhojë edhe përfaqësimin e saj në raport me palët e treta) do duhet t’i referohemi nenit 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 *“Për partitë politike”* i ndryshuar, i cili parashikon se *“Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit”*. Pikërisht në përmbushje të këtij qëllimi (pjesëmarrjes në zgjedhje) dhe gjetjes së zgjidhjes për përfaqësimin e këtij bashkimi vullnetar të shtetasve (anëtarët e Partisë Demokratike të Shqipërisë) mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose interesave të përbashkëta politike, secili fraksion që legjitimohet për të qenë palë e hetimit administrativ legjitimohet edhe për çregjistrimin e palës tjetër si subjekt zgjedhor**

<sup>4</sup> Vendimi nr. 44, datë 03.03.2023 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me palë kërkuese Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit dhe palë ankimese Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga nënkryetari i partisë, z. Enkelejd Alibeaj

nëse kjo palë nuk i plotëson kushtet për t'u konsideruar e tillë pavarësisht vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimmarrje kjo që nuk mund të konsiderohet e formës së prerë as në rastin kur ky i fundit ka vlerësuar të regjistrojë një palë si subjekt zgjedhor. Partitë politike, në ndryshim nga çdo grupim tjetër shtetasish, janë subjekt juridik i posaçëm për shkak të qëllimit që kanë, atë të përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit, e për rrjedhojë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e demokracisë në vend. **Mosmarrëveshjet e tejzgjata në lidhje me organet e një partie politike, e për më tepër me organet që supozohet të përfaqësojnë partinë politike me palët e treta, tregojnë se partia politike ka ceduar në qëllimin e saj për përfaqësimin e anëtarësisë së saj (bashkimi vullnetar i shtetasve), ndaj në këtë rast edhe njëri fraksion ka interes të ligjshëm për të kërkuar çregjistrimin e fraksionit tjetër si subjekt zgjedhor, për aq kohë sa mosregjistrimi i asnjërit prej fraksioneve si subjekt zgjedhor do të nxiste të dy fraksionet (për aq kohë sa pretendohet se përfaqësojnë të njëjtin bashkim vullnetar të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike) për gjetjen e një zgjidhje ligjore për shuarjen e mosmarrëveshjeve që kanë brenda partisë politike.**

7. Sa i përket themelit të ankimit në lidhje me çregjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, të përfaqësuar nga kryetari Lulzim Basha, unë, anëtari në pakicë, i qëndroj arsytimit të vendimit të KAS nr. 27, datë 16.03.2023, vendim ky që trajtoi për herë të parë çështjen e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë (në situatë mosmarrëveshjeje në lidhje me organet që përfaqësojnë atë me palët e treta). Më konkretisht, në këtë vendim KAS ka arsyetuar se:

*“Për efekt të regjistrimit në zgjedhje, të dhënat identifikuese janë ato që deklaron subjekti. Nëse midis tyre dhe të dhënave që përmban vërtetimi gjyqësor ka mospërputhje, atëherë KQZ-ja është e detyruar të hetojë se mos këto mospërputhje vijnë për shkak se ndodhemi përpara një subjekti me identitet tjetër, të ndryshëm nga ai që figuron i regjistruar në gjykatë, apo subjekti është i njëjtë dhe të dhënat e vërtetimit gjyqësor janë të paazhornuara. Për të dhëna të paazhornuara, KQZ-ja nuk mund të vendosë përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet. Hetimi administrativ i Komisionerit në rastin e ankuesit të përfaqësuar nga z. Indrit Sefa provoi se mbajtja në regjistër e emrit të z. Lulzim Basha si kryetar i Partisë, kur ai ka dhënë dorëheqjen*

dhe është zëvendësuar në detyrë nga z. Enkelejd Alibeaj, përbën mosazhornim të regjistrit dhe jo provë se në fakt kryetar i partisë vazhdon të jetë z. Basha.

...

Nga dokumentacioni shoqërues i kërkesës për regjistrim të të njëjtit ankues rezulton se “Deklarata e Angazhimit Solemn e Kryetarit të Partisë” është nënshkruar nga “Kryetari i Partisë me Autorizim” (sic), z. Enkelejd Alibeaj. Për këtë shkak, dokumentacionit i është bashkëlidhur një dokument shtesë, i pakërkuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor, me titullin “Autorizim i përgjithshëm”, i cili është nënshkruar nga Kryetari i Partisë z. Lulzim Basha.

**Nga dokumentacioni shtesë i paraqitur gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës përfshihet shkresa nr. 27/3, prot., datë 14.03.2023 e z. Indrit Sefa, Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore i PD, protokolluar në KQZ me nr.1650, datë 14.03.2023. Ky dokument rikonfirmon informacionin se Kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen nga funksioni më datë 21 mars 2022 dhe kumton se “nënkryetari i zgjedhur nga Këshilli Kombëtar dhe që ishte i vetmi në detyrë për këtë përgjegjësi, z. Enkelejd Alibeaj, është komanduar të drejtojë Partinë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri”.**

...

KAS-i është në dijeni të faktit se legjitimiteti i nënkryetarit, z. Enkelejd Alibeaj si kryetar i komanduar i Partisë Demokratike është kontestuar publikisht nga formacioni rival brenda Partisë Demokratike. **Por kontestimi i zgjedhjes në detyrë të kryetarit, apo i caktimit të kryetarit të komanduar bëhet gjithashtu sipas rregullave statutore dhe shqyrtohet nga instancat kompetente statutore. Të tretët nuk kanë asnjë zë në këtë kapitull dhe nuk mund të zgjedhin t’u njohin apo të mos t’u njohin kryetarin e zgjedhur apo të komanduar të partisë. Në dijeninë e KAS-it nuk ka asnjë procedurë kontestimi statutor për drejtimin e Partisë Demokratike nga z. Enkelejd Alibeaj, as ndonjë procedurë kontestimi gjyqësor. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë shkak ligjor për KQZ-në për të dyshuar në vazhdimësinë institucionale nga ish kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj”.**

8. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, duke qenë se në KAS u depozituan akte si “Procesverbali i Mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike (datë 27.07.2023)” dhe “Kërkesa për ndryshime në Regjistrin e Partive Politike, në të dhënat që përfshijnë “emrin e kryetarit” si dhe

*depozitimin e vendimit nr. 1, datë 27.07.2023 të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike”, nga të cilat rezultonte ndër të tjera se ishte pranuar dorëheqja e datës 21 mars 2022 e Kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha, por po ashtu ishte pranuar edhe dorëheqja e datës 17 maj 2023 si nënkryetar i Partisë Demokratike e z. Enkelejd Alibeaj, si dhe njëkohësisht, nga shkresa me nr. 5306/3 prot., datë 30.08.2023 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se z. Lulzim Basha, është regjistruar për herë të fundit si kryetar i Partisë Demokratike, me vendimin nr. 10, datë 13.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim ky që reflekton zgjedhjen e tij të fundit përpara dorëheqjes së tij të datës 21 mars 2022, dorëheqje kjo e konfirmuar edhe nga KAS me vendimin nr. 17, datë 16.03.2023, por e pranuar edhe me vendimin e sipërcituar të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, unë anëtari në pakicë, jam i mendimit se njohja nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i z. Lulzim Basha si kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë vetëm në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vërtetim ky që nga provat në shqyrtim administrativ rezulton fare qartë se nuk pasqyron situatën ligjore në Partinë Demokratike, në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, bie ndesh me praktiken e KAS për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, praktikë kjo e konfirmuar edhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.*

9. Pala e interesuar në këtë shqyrtim administrativ, Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Lulzim Basha, pavarësisht se në procedurat e regjistrimit të këtij subjekti zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 e pranoi shkresërisht dhe në seancë publike dorëheqjen e z. Lulzim Basha si kryetar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, por po ashtu u njoh dhe me kontestimet e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë (vendimi i këtij organi i datës 27.07.2023), zgjodhi të mos paraqesë asnjë provë për të vërtetuar rizgjedhjen e z. Lulzim Basha si kryetar i kësaj partie politike pass dorëheqjes së tij të datës 21 mars 2022. Ndodhur në këto kushte, KAS nuk mund të ndryshonte qëndrim në lidhje me identifikimin e organit që përfaqëson këtë parti politike me palët e treta.

10. Për sa më sipër, unë anëtari në pakicë, vlerësoj se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi “Partia Demokratike e Shqipërisë”, e përfaqësuar nga z. Sali Berisha, është pjesërisht e bazuar

dhe ajo duhej të ishte pranuar pjesërisht nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, vetëm sa i përket pjesës së kërkesës për çregjistrimit si subjekt zgjedhor të Partisë Demokratike të Shqipërisë me kryetar z. Lulzim Basha.

**Anëtar: Ledio Braho**